

plumb në pjesën e veshkave. Plaga ishte vdekjeprurëse dhe ai ndërroi jetë pas 15 minutash, në autoambulancë. E kanë varrosur në Knjazhevc më 1.08.1998.

Burimet: deklarata B.R, FDH-21713; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 702; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 283.

Zize Sylaj

(1898, shqiptare nga Grabanica, komuna e Klinës/Klina, dy fëmijë)

Aze (Zekë Sylaj) Brahimaj

(1921, shqiptare nga Jabllanica/Jablanica, komuna e Gjakovës/Đakovica, gjashtë fëmijë)

Zizja e moshëthyer ka kaluar te vajza e saj Aze në Jabllanicë/Jablanica, në muajin maj të vitit 1998. Në shtëpinë e Azes u mblidhnin pjesëtarë të UÇK-së. Ajo u përgatiste ushqime, të cilat u shpërndante nëpër pozicionet e tyre. Herën e fundit e ëma dhe e bija mbahen në mend të shiheshin të gjalla gjatë betejës treditore mes forcave serbe dhe ushtarëve të UÇK-së, në **muajin gusht të vitit 1998**, në **Jabllanicë/Jablanica**. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, i afërmi i Zizes dhe i Azes, Avdyl Zeneli, i kishte gjetur trupat e tyre të pajetë. Ishin të masakruara. U varrosën në varrezat e Jabllanicës/Jablanica.

Burimi: deklarata A.Z, FDH-20192.

Jeton (Idriz) Hoxha

(5.12.1973, shqiptar nga Cërmjani/Crmljane, komuna e Gjakovës/Đakovica, student, pjesëtar i UÇK-së)

Jetoni ka qenë student i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjakovë/Đakovica. U martua në pranverë të vitit 1998. Ka aderuar në UÇK në fund të prillit 1998, së bashku me vëllezërit Istrefin dhe Artanin. Në fillim nuk ishte i armatosur. Kur u ngarkua me armën e vet, u caktua me detyrë në fshatin e tij dhe u bë pjesëtar i njësitit që e komandonte Ali Hasi. Forcat serbe e kanë sulmuar fshatin [**Cërmjan/Crmljane**] më **2.08.1998**. Sulmet kryheshin me bombardime dhe banorët tentonin të largoheshin nga fshati duke ikur me vrap. Jetoni e

mbante pozicionin e vet në fshat. Për një çast, ai e vërejti nënën dhe motrën duke kaluar pranë shkollës së mesme. E lëshoi pozicionin dhe me Sabri Hoxhën tentuan që tu ndihmonin të braktisnin fshatin dhe largoheshin sa më shpejt nga rreziku, por në afërsi të shkollës, pranë një muri, Jetoni u qëllua nga ciflat e një predhe. Ka gjetur vdekjen në vend. Po atë ditë, pasi pushuan sulmet, familjarët e kanë varrosur Jetonin në varrezat lokale. Ai prehet atje edhe sot.

Burimet: deklarata A.H, FDH-32439; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Idriz (Bajram) Gucati

(27.09.1952, shqiptar nga Prizreni/Prizren, arsimtar, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Idrizi i mbante mësimet nga gjuha shqipe në një shkollë të mesme në Prizren. Jetonte me familjen e tij në qendër të qytetit. Në datën 24.04.1998, u inkuadrua në UÇK në Jabllanicë/Jablanica. Ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **2.08.1998**. U qëllua për vdekje përderisa e mbante pozicionin e vet në vendin e quajtur *Pika e Shqiponjës/Orlovo gnezdo* [**Jabllanicë/Jablanica**]. Një ditë më vonë, pjesëtarë të UÇK-së e kanë varrosur në varrezat e Jabllanicës/Jablanica. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 2000, mbejtjet e tij mortore u rivarrosen me nderime ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në të njëjtin fshat.

Burimet: deklarata N.G, FDH-32788; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Željko (Dragiša) Božić

(27.11.1970, serb nga Lipjani/Lipljan, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Željko ka lindur në Vishegrad [BdheH]. Pas mbarimit të trajnimit për oficer police, Željko u punësua në vitin 1991 në Stacionin Policor të SHPB-së së Lipjanit/Lipljan. Atje u martua me Draganen. I kishin dy fëmijë. Ka rënë në luftimet me forcat e UÇK-së, të cilat janë zhvilluar më **2.08.1998**, rreth orës 19:00, në fshatin **Jabllanicë/Jablanica**. E varrosën në fshatin e Bllaces përkaj